



Prishtinë, 09 shkurt 2010
Kodi i ZRRE-së: V_224_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në dispozitat e Neneve 15.2 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
3. Kërkesën e KEK SH.A për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Licencave të KEK SH.A-së, të datës 28.12.2009,

Në mbledhjen e mbajtur më 09 shkurt 2010 nxori këtë:

VENDIM

I. I LEJOHET KEK Sh.A-së derogimi në zbatimin e disa neneve dhe dispozitave të:

- Licencës për Gjenerim të Energjisë Elektrike TC Kosova A
- Licencës për Gjenerim të Energjisë Elektrike TC Kosova B
- Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes
- Licencës për Furnizim Publik me Energji Elektrike dhe
- Licencës për Furnizim/Tregti me Energji Elektrike.

1. Të gjitha Nenet dhe dispozitat tjera të licencave të KEK Sh.A-së mbesin në fuqi.
2. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
3. Vendimi hyn në fuqi datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
4. Vendimit i bashkëngjitet Shtojca me dispozitat dhe Nenet e deroguara.



Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën e juridiksionit përkatës brenda (14) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose nga data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Dr. Nysret Avdiu, Anëtar

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar



Shtojcë: Nenet e deroguara (shtyrje afati) me datë 09 shkurt 2010 të licencave të KEK SH.A-së

Licenca e Gjenerimit TC Kosova A					
Nr.	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 17.02.09 deri me:	Derogimi i datës 09.02.10 deri me:	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Bizneset gjeneruese	31 dhjetor 2008	31 mars 2009	31 mars 2010	Dispozita 2.1 e Nenit 2 të kësaj licence, që ka të bëjë me Raportin Financiar të Audituar për vitin 2009 nuk derogohet.
2.	Neni 14 - Mjedisi	31 dhjetor 2009	-	30 qershor 2010	Obligohet i Licencuari që deri më 30 qershor 2010 të dërgoi në ZRRE shkresën nga MMPH lidhur me plotësimin e kushteve mjedisore.
3.	Neni 15- Obligimi i Sigurimit	31 dhjetor 2009	-	31 dhjetor 2010	-
Licenca e Gjenerimit TC Kosova B					
Nr.	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 17.02.09 deri me:	Derogimi i datës 09.02.10 deri me:	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Bizneset gjeneruese	31 dhjetor 2008	31 mars 2009	31 mars 2010	Dispozita 2.1 e Nenit 2 të kësaj licence, që ka të bëjë me Raportin Financiar të Audituar për vitin 2009 nuk derogohet.
2.	Neni 12 - Mjedisi	31 dhjetor 2009	-	30 qershor 2010	Obligohet i Licencuari që deri më 30 qershor 2010 të dërgoi në ZRRE shkresën nga MMPH lidhur me plotësimin e kushteve mjedisore.
1.	Neni 15- Obligimi i Sigurimit	31 dhjetor 2009	-	31 dhjetor 2010	-
Licenca për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes					
Nr.	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 17.02.09 deri me:	Derogimi i datës 09.02.10 deri me:	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Bizneset e Operatorit të Shpërndarjes	31 dhjetor 2008	31 mars 2009	31 mars 2010	Dispozita 2.1 e Nenit 2 të kësaj licence, që ka të bëjë me Raportin Financiar të Audituar për vitin 2009 nuk derogohet.
2.	Neni 11-Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit	31 dhjetor 2008	30 qershor 2009	30 qershor 2010	-
3.	Neni 12 Standardet e Sigurisë së Operimit	31 dhjetor 2008	30 qershor 2009	30 qershor 2010	-
4.	Neni 13-Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përbushjes së Bizneseve të Operatorit të Shpërndarjes	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2009	30 qershor 2010	-
5.	Neni 22- Obligimi i Sigurimit	31 dhjetor 2009	-	31 dhjetor 2010	-



Licenca për Furnizim Publik me Energji Elektrike					
Nr.	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 17.02.09 deri me:	Derogimi i datës 09.02.10 deri me:	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizimit Publik	31 dhjetor 2008	31 mars 2009	31 mars 2010	Dispozita 2.1 e Nenit 2 të kësaj licence, që ka të bëjë me Raportin Financiar të Audituar për vitin 2009 nuk derogohet.
2.	Neni 8-Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përmbushjes	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2009	30 qershor 2010	-
Licenca për Furnizim/Tregti me Energji Elektrike					
Nr.	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 17.02.09 deri me:	Derogimi i datës 09.02.10 deri me:	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizim/tregtisë me energji elektrike	31 dhjetor 2008	31 mars 2009	31 mars 2010	Dispozita 2.1 e Nenit 2 të kësaj licence, që ka të bëjë me Raportin Financiar të Audituar për vitin 2009 nuk derogohet.
2.	Neni 8-Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përmbushjes	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2009	30 qershor 2010	-